



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 30.07.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E  
LINJAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE 110 KV, BANJË-  
CËRRIK DHE 220 KV, MOGLICË-ELBASAN

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e Linjave të Transmetimit të Energjisë Elektrike 110 kv, Banjë-Cërrik dhe 220 kv, Moglicë-Elbasan, me subjekt kërkues shoqërinë “Devoll Hydropower” Sh.a.
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



**Z. DAMIAN GJIKNURI**

MINISTËR I ENERGJISE DHE INDUSTRISE



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT